



*Shejh*  
MUHAMED NASIRUDIN EL ALBANI

# DËLIRJA, EDUKIMI DHE NEVOJA E MËSLIMANËVE PËR TO

# DËLIRJA, EDUKIMI

DHE NEVOJA E MUSLIMANËVE PËR TO

DIJETARI I MADH, EL MUHADDITH

MUHAMED NASIRUDIN EL ALBANI

ALLAHU E MËSHIROFTË

Titulli original: التصفية والتربية وحاجة المسلمين إليهما

Et-Tesfijetu uet-terbijetu ue haxhetul muslimine ilejhime

Titulli: Dëlrirja, edukimi dhe nevoja e muslimanëve për to

Autor: Muhamed Nasirudin el Albani

Përktheu: Jusuf Kapidani

Publikimi në web: [www.revistamedina.net](http://www.revistamedina.net)

© të gjitha të drejtat janë të përkthyesit

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

## **Parathënia e botuesit**

Gjithë lavdërimet janë vetëm për Allahun. Atë e lavdërojmë dhe vetëm prej Tij ndihmë e falje kërkojmë. Kërkojmë strehim tek Allahu nga të këqijat e veteve dhe veprave tona. Kë udhëzon Allahu nuk ka kush ta humbasë, e kë e humbet nuk ka kush e udhëzon. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut i Vetëm e i Pashoq, dhe dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij.

Në vijim: ky libër: “Dëlrja, edukimi dhe nevoja e muslimanëve për to”, në origjinë është një ligjëratë e mbajtur nga muhadithi, dijetari i madh, shejh Muhamed Nasirudin el Albani – Allahu e mëshiroftë – në Institutin Sheriatik në Aman, Jordani, afërsisht para tridhjetë vitesh, ku shejhu qartësoi në të menhexhin (metodologjinë) e vërtetë të cilin e kemi për detyrë ta zbatojmë të gjithë. Këtë e përmbloodhi vetëm në dy fjalë: dëlrje (et Tesfije) dhe edukim (et Terbije). Ky dijetar kaloi gjithë jetën e tij në këtë menhexh. Akiden (besimin) e pastron nga ato që i janë mveshur prej besimeve të kota e të kalbura, prej trillimeve e ortakërive. Pastron Sunetin nga ajo që është futur e që nuk është pjesë e saj. Kjo bëhet duke dalluar të saktin (es Sahih) dhe të mirin (el Hasen) nga i dobëti (Ed Daif), i shpikuri (el Meuduë) dhe nga ai që nuk ka asnjë bazë. Pastron Fik'hun (legjislaionin) nga ajo që i është mveshur prej mendimeve dhe shpikjeve të cilat kundërshtojnë tekstet e qarta (Kuranin e Sunetin). Në këtë vazhdë filloi pikësëpari edukimin e vetes, e së dyti atyre rreth tij,

në ç'ka është saktësuar dhe vërtetuar prej të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Shejhu – Allahu e mëshiroftë – i ftoi të gjithë njerëzit që ta përqafojnë këtë menhexh të vërtetë: “Dëlrirje dhe edukim”. Atij iu përgjigjën shumë prej njerëzve të mirë nga e gjithë bota, njerëzit e dijes, dijetarë e nxënës dhe kështu ripërtëritja e diturisë së saktë filloi të përhapet në gjitha skajet e Tokës.

El Mektebetul Islamiye në Aman e pa të arsyeshme përhapjen e këtij libri të dobishëm, i cili bën pjesë në dijen e çmuar e të vyer të shejhut, që Allahu e mëshiroftë, në mënyrë që dobia të përhapet e t'i shërbejë muslimanëve në gjithë botën dhe shejhu të shpërblehet pas vdekjes së tij in sha Allah.

Botuesi

Aman në 4 Dhulhixheh 1420h

## DËLIRJA DHE EDUKIMI

Gjithë lavdërimet janë vetëm për Allahun. Atë e lavdërojmë dhe vetëm prej Tij ndihmë e falje kërkojmë. Kërkojmë strehim tek Allahu prej të këqijave të veteve dhe punëve tona. Atë që Allahu e udhëzon nuk ka kush ta humbasë e atë që e humbet nuk ka kush e udhëzon. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut i Vetëm e i Pashoq dhe dëshmoj se Muhamedi është robi e i Dërguari i Tij.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تُقَاتِهِ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُمْ مُسْلِمُونَ

**“O ju që besuat! Kini frikë Allahun me një frikë të vërtetë e mos vdisni vetëm se muslimanë.”<sup>1</sup>**

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً ۚ وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ وَالْأَرْحَامَ ۚ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا

**“O ju njerëz! Kini frikë Zotit tuaj (adhurojeni Atë të vetëm e pa ortakëri) që ju ka krijuar prej një veteje (Ademit) dhe nga ai krijoi palën (shoqen) e saj dhe prej atyre dyve u shtuan shumë burra e gra. Kini frikë Allahun që me Emrin e Tij përbetoheni, ruajeni farefisin (ruani të drejtat e tyre), se Allahu është mbikëqyrës mbi ju.”<sup>2</sup>**

---

<sup>1</sup> Al Imran 102.

<sup>2</sup> En Nisa 1.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا (70) يُصْلِحْ لَكُمْ أَعْمَالَكُمْ وَيَغْفِرْ لَكُمْ  
ذُنُوبَكُمْ ۗ وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ فَازَ فَوْزًا عَظِيمًا

**“O ju që besuat! Kini frikë Allahun (në ç’do situatë) dhe thoni fjalë të drejta. (Nëse jeni të tillë, si shpërblim) Ai ua përmirëson punët dhe ua fal mëkatet tuaja (të cilat janë shkak i shkatërrimit). Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, padyshim që ka fituar një fitim të madh.”<sup>3</sup>**

E më pas; nuk ka asnjë dyshim se fjala më e mirë është Fjala e Allahut e udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit sal-IAllahu alejhi ue sel-lem. Gjërat më të këqija janë të shpikurat e tyre, ku çdo e shpikur është bidat, çdo bidat është humbje e çdo humbje të çon në Zjarr.

Në vijim; siç e dini të gjithë, sot jemi në një kohë që muslimanët kanë prekur njëfarë kufiri, ku ai që beson Allahun dhe të Dërguarin e Tij nuk mund të shkojë më keq në poshtërim e skllavërim ndaj të tjerëve. Për këtë dhe për shkak të ndjeshmërinë së secilit prej nesh, për atë që na ka rënë nga ky poshtërim kaplues, që për të ardhur keq është në të gjithë vendet muslimane – në nivele të ndryshme –, përherë pyesim njëri-tjetrin në shoqërinë e gjerë, shtresën e arsimuar dhe simpoziumet tona, për shkakun që cili i çoi muslimanët në këtë gjendje poshtëruese e të keqe, dhe në këtë situatë të ulët e të sikletshme. Pyesim për sekretin sesi arritën të bien në këtë nivel të ulët nëpërkëmbjeje, ashtu siç pyesim për ilaçin dhe mjekimin, në mënyrë që të shpëtojmë nga ky poshtërim e mjerim.

---

<sup>3</sup> El Ahzab 70-71.

Pas kësaj që thamë, ofrohen mendime të llojllojshme dhe shtohen pikëpamjet. Gjithkush vjen me një menhëxh apo rrugë të cilën e shikon zgjidhje të problemit dhe kurim të kësaj sëmundje të rëndë.

Kurse unë mendoj që këtë problem e ka përmendur i Dërguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe e ka përshkruar në disa hadithe të sakta të tij, ku ka qartësuar edhe mjekimin e tij. Nga këto hadithe është fjala e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:

إِذَا تَبَايَعْتُمْ بِالْعَيْنَةِ ، وَأَخَذْتُمْ أَذْنَابَ الْبَقَرِ ، وَرَضَيْتُمْ بِالزَّرْعِ ، وَتَرَكْتُمُ الْجِهَادَ ، سَلَّطَ اللَّهُ عَلَيْكُمْ ذُلًّا لَا يَنْزِعُهُ حَتَّى تَرْجِعُوا إِلَى دِينِكُمْ

**“Kur të tregtoni me *El Ij'ineh*,<sup>4</sup> kur të kapni bishtat e lopëve,<sup>5</sup> kur të kënaqeni me të mbjellat e të lini xhihadin, do t'ua hedh Allahu tek ju poshtërimin dhe nuk do t'ua largojë atë, derisa të ktheheni në fenë tuaj.”<sup>6</sup>**

Në këtë hadith, megjithëse i shkurtër, gjejmë përmendjen e sëmundjes e cila është përhapur aq sa i ka përfshirë muslimanët. I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem përmend këtu dy lloje sëmundjesh, jo për të kufizuar por për të dhënë shembull:

---

<sup>4</sup> Është quajtur kështu sepse blerësi nuk ka qëllim mallin, por paratë (*El Ajn*) në mënyrë që të përfitojë prej tyre. Burimi: Shpjegimi i Bulug El Meram, shejh Muhamed ibn Salih El Uthejmin hadithi nr. 805. (shp)

<sup>5</sup> Të mbillni tokën, sepse njerëzit përdornin qetë për të tërhequr parmendën. (shp)

<sup>6</sup> Es Sahihah 11.



Lloji i parë: rënia e muslimanëve në disa gjëra të ndaluara duke bërë hile për to, megjithëse janë të vetëdijshëm. Kjo është brenda fjalës së tij **“kur të tregtoni me *El Ij'ineh*.”** *El Ij'ineh*, siç është e njohur në librat e Fik'hut, është një lloj shitblerjeje që ky hadith dëfton për ndalimin e saj. Megjithatë disa dijetarë – pa përmendur të tjerë – mendojnë lejimin e kësaj shitblerjeje.

Forma e saj është kur dikush blen nga një tregtar një mall çfarëdo, le të jetë makinë për shembull; e blen atë me një çmim i cili i jepet me këste dhe për një kohë të caktuar. Mandej ky blerës kthehet në shitës i po kësaj makine për shitësin e parë me një çmim më të vogël se çmimi që e bleu, por ama me para në dorë dhe shitësi i parë – i cili u kthye në blerës – e paguan çmimin me para në dorë me më pak sesa e bleu ai me këste dhe me borxh.

Kjo makinë le të jetë shitur për shembull për dhjetëmijë Lira për (ta paguar si hua) pas një kohe të caktuar. Blerësi çohet dhe ia shet shitësit të parë për tetëmijë me para në dorë dhe atij i shkruhet shlyerja duke shtuar dymijë Lira.

Kjo shtesë është kamatë. Detyra për muslimanin i cili dëgjon ajetet e Allahut azze ue xhel-le dhe hadithet e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem të cilat e ndalojnë kamatën, është që të mos e lejojë këtë lloj prej shitblerjes *“El Ij'ineh”* meqenëse paska një shtesë në kthimin e parave. Sepse kjo shtesë është kamatë e dukshme, por disa njerëz ende mendojnë lejimin e saj. Kjo për shkak se është e vendosur në kapitullin e shitblerjes dhe për këtë argumentohen me përgjithësime të cilat dëshmojnë lejimin e shitblerjes, si për shembull ajeti i njohur:

وَأَحَلَّ اللَّهُ الْبَيْعَ وَحَرَّمَ الرِّبَا

## **“Allahu lejoi shitblerjen dhe e ndaloi kamatën.”<sup>7</sup>**

Thanë që kjo është një shitblerje dhe nuk ka problem nëse shtohet apo pakësohet!

E vërteta është se blerësi i cili e bleu me dhjetëmijë për një kohë të caktuar, mandej e shiti me tetëmijë me para në dorë, dëshiron me këtë veprim të marrë tetëmijëshen dhe për shkak se e di që ky shitës musliman – sipas pretendimit të tij – nuk do t’ia huazonte tetëmijë me tetëmijë për Fytyrën e Allahut të Lartësuar! Por, ai donte shtesë! Së bashku, ata bënë hile për ta lejuar këtë shtesë nën emrin e shitblerjes.

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem pikësëpari është shpjegues i njerëzve ashtu siç thotë Zoti ynë tebareke ue teala:

وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ

**“Ty ta zbritëm përkujtimin (Kuranin) që t’u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre.”<sup>8</sup>**

Së dyti: i Dërguari i Allahut është ashtu siç e cilësoi Zoti ynë tebareke ue teala në fjalën e Tij:

بِالْمُؤْمِنِينَ رَءُوفٌ رَحِيمٌ

**“Me besimtarët shumë i butë e shumë i mëshirshëm.”<sup>9</sup>**

---

<sup>7</sup> El Bekareh 275.

<sup>8</sup> En Nahl 44.

Prej butësisë dhe mëshirës së tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ndaj nesh, është se na i vuri në dukje të fshehtat e hileve të shejtanit tek bijtë e njeriut, dhe na paralajmëroi që të mos biem në grackat e tij në shumë e shumë hadithe, prej tyre është edhe ai që po flasim.

Tha sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:

إِذَا تَبَايَعْتُمْ بِالْعِينَةِ

**“Kur të tregtoni me *El Ij'ineh*”,** pra kur ta lejoni atë që Allahu dhe i Dërguari i Tij e kanë ndaluar me hilet më të ulëta, nën emërtimin që është shitblerje, por në të vërtetë kjo është veçse një perde. Ky është borxh kundrejt një shtese, e kjo qartazi është kamatë.

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem na paralajmëroi në këtë hadith nga rënia në këtë lloj hileje për të lejuar atë që Allahu e ndaloi. Kjo është më e rrezikshme se rënia e muslimanit në haram duke e ditur që është e tillë, sepse shpresohet prej tij që një ditë të kthehet tek Zoti i Tij e të pendohet, për shkak se është i vetëdijshëm që ajo vepër është haram. Por, nëse puna e keqe i është lustruar për ndonjë shkak të caktuar, nga shpjegimi i gabuar ose injoranca e thellë, ku mendoi se s'ka gjë të keqe në të, është mëse normale që mos t'i shkoi ndërmend ndonjë ditë të pendohet tek Allahu azze ue xhel-le.

Pra, rreziku i haramit që bëhet hallall në arsyetim apo besim është shumë herë më i rëndë se harami i qartë. Ai që han kamatën duke e ditur dhe besuar që është kamatë, ky njeri

---

<sup>9</sup> Et Teubeh 128.

megjithëse është në luftë me Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ashtu siç thuhet në tekstin e ajetit, rreziku i tij është më i lehtë në përfundim se ai i cili han kamatën dhe beson që po bën diçka të lejuar.

Ky është njëlloj si shembulli i atij që pin pije dehëse dhe beson që është haram. Shpresohet për të që të pendohet tek Allahu azze ue xhel-le. Kurse ai që pin pijet dehëse, e beson për një shkak të caktuar që është e lejuar, kjo është më e rrezikshme se rasti parë, për shkak se nuk imagjinohet të pendohet asnjëherë prej saj, përderisa ka gabuar në kuptimin dhe gjykimin e kësaj çështjeje.<sup>10</sup>

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në këtë hadith e përmendi shitblerjen *El Ij'ineh*, ashtu siç e thamë në fillim të fjalës, për ta dhënë si shembull, e jo për ta kufizuar, që dëfton se çdo haram që muslimani e kryen duke e bërë të lejuar me një mënyrë komentimi çfarëdo, është prej pasojave që Allahu azze ue xhel-le ta poshtërojë, dhe për shkak të tij t'i poshtërojë muslimanët, në goftë se kjo përhapet tek ata dhe zgjerohet.

Mandej përmendi edhe llojin e dytë prej gjërave që të gjithë njerëzit e dinë se ajo e kundërshton sheriatin, ku tha:

إِذَا تَبَايَعْتُمْ بِالْعِينَةِ ، وَأَخَذْتُمْ أَذْنَابَ الْبَقَرِ ، وَرَضِيْتُمْ بِالزَّرْعِ

**“Kur të tregtoni me *El Ij'ineh*, kur të kapni bishtat e lopëve e kur të kënaqeni me të mbjellat.”**

---

<sup>10</sup> Them: Kështu është bidati. Ai është më i rrezikshëm se gjynahu të cilin vepruesi i saj e di që është gjynah.

Pra: u preokupuat në ndjekje pas plaçkës së dunjasë, fitimit të riskut, në emrin e asaj që Allahu azze ue xhel-le na ka urdhëruar të rendim pas riskut.

Në këtë mënyrë muslimanët e ekzagjerojnë, harrojnë detyrat që ia ka obliguar Allahu dhe hutohen duke rendur pas bujqësisë, bagëtisë e të tjera përfitimeve të ngjashme. Kjo i bën të harrojnë çfarë i ka obliguar Allahu prej detyrave dhe si shembull përmendi xhihadin në rrugë të Allahut, ku tha sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:

إِذَا تَبَايَعْتُمْ بِالْعِينَةِ ، وَأَخَذْتُمْ أَذْنَآبَ الْبَقْرِ ، وَرَضِيْتُمْ بِالزَّرْعِ ، وَتَرَكْتُمْ الْجِهَادَ ، سَلَطَ اللَّهُ عَلَيْكُمْ ذُلًّا لَا يَنْزِعُهُ حَتَّى تَرْجِعُوا إِلَى دِينِكُمْ

**“Kur të tregtoni me *El Ij'ineh*, kur të kapni bishtat e lopëve, kur të kënaqeni me të mbjellat e të lini xhihadin, do t'ua hedh Allahu tek ju poshtërimin dhe nuk do t'ua largojë atë, derisa të ktheheni në fenë tuaj.”**

Ky hadith, siç e shihni është prej shenjave pejgamberike. Poshtërimi i përmendur është bërë realitet tek ne, që për të ardhur keq është i dukshëm. E kemi për detyrë që nga ky hadith të marrim ilaçin, pasi që u përcaktua sëmundja dhe ç'ka sjell ajo me vete prej poshtërimit.

Bëmë shkaqet që na çuan te sëmundja, që në këtë rast është poshtërimi. Atëherë nuk na ngelet gjë tjetër veç të kthehemi në përdorimin e ilaçit të cilin e përcaktoi i Dërguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, dhe e tha qartësisht se nëse kthehemi tek Ai, Allahu do të na e largojë këtë poshtërim.

Njerëzit e lexojnë këtë hadith dhe e dëgjojnë shumë herë fjalën e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: **“Derisa të ktheheni në fenë tuaj”** dhe mendojnë se kthimi ne fe është diçka e lehtë, kurse unë mendoj se kthimi tek feja ka nevojë – siç thonë tek ne – për “shkriftim supesh”.<sup>11</sup> Kjo, sepse të gjithë e dimë se për fenë janë bërë shumë përpjekje për t’ia ndryshuar shumë të vërteta. Disa prej tyre kanë arritur të shkojnë te ky ndryshim e devijim. Një pjesë e këtij ndryshimi është i njohur tek shumë njerëz, e një pjesë e tij nuk është, madje përkundrazi, tek shumica e njerëzve ka çështje – disa në besim e disa në degëzime të normave fetare (fikhije) – që ata mendojnë se janë prej feje, mirëpo në realitet nuk janë aspak të tilla.

Shembulli i mëparshëm nuk është larg, ajo është sëmundja e parë të cilën i Dërguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e përmendi në këtë hadith **“kur të tregtoni me *El Ij’ineh*”**. Shitblerja *El Ij’ineh* nuk është çështje e padiskutueshme tek të gjithë, apo është haram i njohur, madje shumë dijetarë vazhdojnë në disa vende islame, për të cilat vende ne shpresojmë që janë fortesë e Islamit dhe larg ndikimit me ato që u ndikuan vendet e tjera muslimane, ata japin fetva për lejimin e kësaj shitblerjeje; kësaj shitblerjeje brenda së cilës ka hile për të lejuar kamatën. Ky është njëri nga shembujt e shumtë të cilat i njohin mirë ata që merren me fikhun Islam.

Kjo lloj shitblerje me gjithë ndalimin që i bëri asaj i Dërguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe bërjen shkaktare që muslimanet kanë rënë në poshtërim, është një nga dhjetëra

---

<sup>11</sup> Përvesh mëngët për punë. (shp)

shembujt që argumentojnë atë që përmendëm, se e kemi detyrë ta kuptojmë fenë nga fillimi, nën dritën e Kuranit dhe Sunetit.

Ne, kur tregojmë se ka dijetarë që i bëjnë hallall disa gjëra për të cilat kanë ardhur tekste të qarta në Sunet për ndalimin e tyre, nuk duam me këtë sharjen apo ofendimin e dijës së këtij i cili bëri hallall atë që hadithi e bëri haram, apo të tallemi me të, por duam këshillimin e muslimanëve dhe gjithashtu duam që të bashkëpunojmë me ata të gjithë, e në veçanti me të angazhuarit në fikhun Islam, në mënyrë që të kuptohet se ku ka ndodhur devijimi i disa njerëzve, cilido qoftë shkaku. Kjo, duke u kthyer në zbatimin e një ajeti të bukur të Kuranit. Ky ajet është i njohur tek të gjithë ne, por të paktë janë ata që përpiqen ta zbatojnë. Ky ajet është fjala e Allahut tebareke ue teal:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ وَأُولِي الْأَمْرِ مِنْكُمْ ۚ فَإِنْ تَنَازَعْتُمْ فِي شَيْءٍ فَرُدُّوهُ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ إِنْ كُنْتُمْ تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ ۚ ذَلِكَ خَيْرٌ وَأَحْسَنُ تَأْوِيلًا

**“Nëse kundërshtoheni në ndonjë gjë, kthejeni atë tek Allahu (Libri i Tij) dhe i Dërguari (tek ai vetë kur ishte gjallë, kurse pas vdekjes tek Suneti i tij) po qe se besoni Allahun dhe Ditën e Fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë.”**<sup>12</sup>

Studiuesit e Fikhut e dinë se shitblerja *El Ij'ineh* e shumë të tjera, tek dijetarët e vjetër ka patur kundërshtim dhe aq më tepër tek të rinjtë. Atëherë, çfarë të bëjnë dijetarët sot me këto çështje që ka pasur kundërshtim? Ajo që unë di është se shumica

---

<sup>12</sup> En Nisa 59.

dërrmuese e tyre këtë kundërshtim e pohojnë dhe të vjetrën e lënë të pandryshuar, siç thuhet.

Në këtë situatë unë them: si të kthehen muslimanët në fenë e tyre duke e ditur që ai është ilaçi të cilin i Dërguari sal-Allahu alejhi ue sel-lem e tha tekstualisht që nëse e marrin, do t’u largohet poshtërimi prej tyre dhe në qoftë se jo, nuk largohet.

إِذَا تَبَايَعْتُمْ بِالْعِينَةِ ، وَأَخَذْتُمْ أَذْنَآبَ الْبَقْرِ ، وَرَضِيْتُمْ بِالزَّرْعِ ، وَتَرَكْتُمْ الْجِهَادَ ، سَلَّطَ اللهُ عَلَيْكُمْ ذُلًّا لَا يَنْزِعُهُ حَتَّى تَرْجِعُوا إِلَى دِينِكُمْ

**“Kur të tregtoni me *El Ij’ineh*, kur të kapni bishtat e lopëve, kur të kënaqeni me të mbjellat e të lini xhihadin, do t’ua hedh Allahu tek ju poshtërimin dhe nuk do t’ua largojë atë, derisa të ktheheni në fenë tuaj.”**

Pra, i vetmi ilaç është kthimi në fe, por siç e dinë të gjithë e në veçanti studiuesit, në fe ekzistojnë kundërshtime të forta dhe jo të kufizuara vetëm në çështje të pakta degësh siç mendojnë shumë autorë librash e dijetarë, por kapërcen edhe në çështjet e akides. Kundërshtim të madh ka ndërmjet Esharive dhe Maturidive, po ashtu mes tyre dhe Mutezilive, pa marrë parasysh grupacionet e tjera dhe që të gjithë na llogariten se janë muslimanë, të gjithëve u drejtohet ky hadith:

سَلَّطَ اللهُ عَلَيْكُمْ ذُلًّا لَا يَنْزِعُهُ حَتَّى تَرْجِعُوا إِلَى دِينِكُمْ

**“Do t’ua hedh Allahu tek ju poshtërimin dhe nuk do t’ua largojë atë, derisa të ktheheni në fenë tuaj.”**



Pra, cila fe qënka kjo në të cilën ne duhet të kthehemi?! A është vallë në bazë të kuptimit të medh'hebit të Filanit?! E kështu me rradhë deri tek i fundit medh'heb që ekziston?! Le ta ngushtojmë mospajtimin vetëm tek katër medh'hebet për të cilat ne themi që janë prej medh'hebeve të Ehli Sunetit.

Cila fe është ajo e cila qënka ilaçi i largimit të poshtëritim prej nesh?! Në qoftë se do të kthehemi në cilindo medh'heb, do gjejmë disa çështje, ose dhjetë, ose dhjetëra çështje të cilat kundërshtojnë Sunetin, madje disa kundërshtojnë edhe Kuranin.

Për këtë unë mendoj se çdo përmirësim që është e obligueshme ta kryejnë thirrësit e Islamit dhe ata që kërkojnë me sinqeritet ngritjen e shtetit Islam, bëhet duke u kthyer ata vetë të mësojnë fenë për në radhë të parë dhe umetin në radhë të dytë. Fenë, me të cilën erdhi i Dërguari sal-IAllahu alejhi ue sel-lem, e tek ajo nuk ka rrugë tjetër – dhe besoj se ky është unanimitet i gjithë dijetarëve – se nuk ka rrugë kthimi në kuptimin e fesë me vërtetësi ashtu siç e zbriti Allahu, vetëm duke studiuar Kuranin dhe Sunetin.

Pashmagshmërisht, imamllarët që Allahu i mëshiroftë – dhe kjo ishte nga vlera që kishin dhe përzgjedhja që Allahu i bëri – paralajmëruan ndjekësit e parë të tyre të cilët kishin aq dituri sa të mos i pasonin, (i paralajmëruan) të mos shkonin pas tyre verbërisht, t'i shndërronin në referencën e kthimit të tyre dhe me këtë të harronin themelin e sheriatit, Kuranin dhe Sunetin.

Besoj se nuk keni nevojë t'ua sjell fjalët e imamëve të cilat që të gjitha vërtiten tek ajo fjalë e vërtetuar nga të gjithë ata: “Po u saktësua hadithi, ai është edhe medh'hebi im.”

Kjo fjalë e tyre na mjafton në këtë moment. Ky është argument që çdo imam nga ata e këshilloi veten, umetin dhe ndjekësit e tij kur i urdhëroi që t'i kthehen hadithit nëse ai bie në kundërshtim me ixhtihadin (përpjekjen) dhe mendimin e tij. Pra, kjo i hap rrugën kthimit tek Kurani e Suneti qoftë edhe në emër të pasimit të imamëve verbërisht.

Të përmendim tani disa shembuj të cilat janë prezent në librat tonë, që mësohen në çdo shkollë e fakultet sheriati etj. Në një prej medh'hebeve Islame: kur namazliu hyn në namaz i lëshon duart poshtë dhe nuk i lidh, përse?! Kështu thotë medh'hebi! Ndërkohë që u munduan gjithë dijetarët e hadithit për të sjellë qoftë dhe një hadith të vetëm, zaten edhe daif, madje edhe të shpikur, ku i Dërguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk e kapte dorën e tij të djathtë mbi të majtën gjatë qëndrimit në këmbë kur ishte në namaz, dhe i tillë hadith nuk ekziston. Pra, a është ky islami?

Jam i vetëdijshëm se disa prej jush do të thonë se kjo është çështje degësh.<sup>13</sup> Ka mundësi që dikush nga ata që nuk i kontrollojnë shprehjet e veta të thotë: kjo është prej të parëndësishmeve. Unë besoj se çdo gjë e cila ka ardhur nga i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në lidhje me fenë dhe adhurimin nuk është asesi prej çështjeve të parëndësishme.

Ne besojmë se çdo gjë me të cilën ka ardhur i Dërguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem fillimisht e kemi detyrë ta përqafojmë si fe, duke e peshuar me argumentet e shariatit, nëse është farz, farz e nëse është sunet, sunet. Ama, ta quajmë diçka të parëndësishme

---

<sup>13</sup> Jothelbësore. (shp)

apo lëvozhgë vetëm e vetëm se është mustehab!<sup>14</sup> Kjo nuk përkon absolutisht me edukatën Islame, sidomos kur brendësinë e frutit mund ta ruajmë vetëm duke ruajtur lëvozhgën. Këtë e them nëse dua të debatoj me ta për termat.

Ky shembull i thjeshtë, që është lëshimi duarve në namaz, përse muslimanët ende vazhdojnë dhe punojnë me të kur hadithet vijnë njëri pas tjetrit në çdo libër Suneti që i Dërguari sal-Allah u alejhi ue sel-lem i lidhte duart?! Ky është vetëm pasim i verbër dhe këmbëngulje në kundërshtim të imamëve në fjalën: “Po u saktësua hadithi, ai është edhe medh’hebi im”.

Ky shembull i thjeshtë mund të mos i kënaqë disa njerëz. Atëherë le të përmendim një shembull tjetër. Disa libra fikhu medh’hebesh, vazhdojnë të përmendin se El Hamr<sup>15</sup> është dy lloje: një i nxjerrë nga rrushi, e ky lloj edhe pakica edhe shumica e tij janë haram. Lloji tjetër i nxjerrë jo nga rrushi; si elbi, gruri, hurmi arabisë dhe të tjera, për të cilat jobesimtarët sot janë prefeksionuar për të nxjerrë Hamr (pije alkoolike) prej tyre. Ky lloj prej Hamrit nuk është i gjithi haram, por vetëm ajo sasi e cila të deh!! Përse kjo fjalë vazhdon të jetë e shkruar në rreshta librash?!

Disa njerëz mund ta mbrojnë atë me mënyra të ndryshme! Jo për gjë, por vetëm se një imam nga imamët e muslimanëve u përpoq dhe e tha këtë fjalë! Të gjithë ne, pa pasur parasysh ndryshimet në medh’heb dhe ndasitë tona, lexojmë në librat e

---

<sup>14</sup> E pëlqyer dhe jo e obligueshme. (shp)

<sup>15</sup> El Hamr është ç’ka të deh nga pijet, lëngu i shtrydhur nga rrushi dhe nga të ngjashmet e saj, (është quajtur ashtu) sepse të mbulon mendjen. El Mu’xhem el Uesit. (shp)

Sunetit me zinxhirë të saktë, fjalën e tij sal-lAllahu alejhi ue sellem:

ما أَسْكِرَ كَثِيرُهُ، فَقَلِيلُهُ حَرَامٌ

**“Çfarë të deh me shumicë, është haram me pakicë”,<sup>16</sup>**  
dhe:

كُلُّ مَسْكِرٍ خَمْرٌ وَكُلُّ خَمْرٍ حَرَامٌ

**“Çdo dehëse është Hamr dhe çdo Hamr është haram.”<sup>17</sup>**

Përse vazhdojnë fjalë të rrezikshme si kjo të ekzistojnë, të cilat njerëzve që janë në buzë greminës së prishjes apo ata që kanë rënë, ua inkurajojnë dhe ua zbukurojnë pirjen e pak Hamri, jo nga rrushi, me argumentin se imam Filani që është dijetar i nderuar, e ka thënë këtë?! Sa argument i çuditshëm!

Ne besojmë se ai është dijetar i nderuar, por dallimi është se ne nuk harrojmë që ai është dijetar i nderuar jo i pagabueshëm. E harrojnë qëllimisht këtë fakt dhe vazhdojnë ta mbrojnë këtë fjalë. Disa prej tyre e shfrytëzojnë për të përhapur pijet dehëse tek muslimanët, kurse disa të tjerë mbrojnë imamin por jo fjalën.

Ndoshta shumë prej jush e dinë se revista “El Arabij” para disa vitesh ka botuar një artikull të dikujt prej tyre i cili shkon dhe e adopton këtë fjalë. Pra, pijet e nxjerra jo nga rrushi, por pijet e njohura sot duken se shumica e tyre nuk nxirren nga rrushi.

---

<sup>16</sup> El Irua 2375.

<sup>17</sup> El Irua 2373.

Nxorri artikullin në revistën “El Arabij” ku i lejoi muslimanëve të pinë ç’të duan prej këtyre pijeve të reja me argumentin, mos pi aq shumë sa të dehesh.

Kjo punë është fantazi, sepse në realitet ashtu siç e dimë të gjithë, pika e parë tërheq të dytën dhe e treta të katërtën e kështu me radhë. Sasia e paktë e cila nuk të deh në vetvete, është një proces që nuk mund të përcaktohet e kufizohet, andaj do të sjelli sasinë e madhe e cila të deh.

Unë them: përse vazhdojnë të qëndrojnë fjalë si kjo në librat e fikhut ku i kundërvihet haditheve të qarta në argumentim dhe të vërtetuara të Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem që i rrëzojnë fjalët e tilla?! Përse i hapim rrugën autorit të tillë dashakeq të përhapi këtë fjalë, të ndërtojë pallate e kështjella mbi të dhe t’u lejojë muslimanëve të pinë pije haram, me kushtin që mos pi aq sa të dehesh dhe pi pak e mos pi shumë!

Ky person që e shkroi këtë, mund të jetë dashakeq, por mund të jetë edhe me qëllim të mirë, dëshiron të ndjekë rrugën e dikujt dhe thotë: “O njerëz! Mos ja vështirësoni muslimanëve. Meqenëse kemi fjalë nga një imam prej imamëve të muslimanëve që ua lejon atyre këtë pije, atëherë përse po e ndalojmë?!” Ky autor mund të jetë i tillë, por si është gjendja jonë kur shohim dikë nga dijetarët e nderuar të Shamit që boton një libër kritike kundër kësaj fjale, dhe në kritikën së tij e gjen të tuhatur. Një herë e mbron atë që e thotë fjalën që autori adoptoi, një herë sjell hadithet të cilat i përmendëm disa prej tyre, që janë kritikë ndaj autorit dhe ndaj kujt u mbështet ai.

Përse e shikojmë të nderuarin dijetar të lëkundur?! Kjo sepse ai e madhëron këtë fjalë duke e parë që e ka burimin nga

një dijetar prej dijetarëve muslimanë, dhe ky dijetar nuk flet me rrëmbim apo injorancë. Edhe unë bashkë me të e them që nuk flet me rrëmbim apo injorancë, por a është ai i pagabueshëm në përpjekjen e tij në të cilën u largua nga rrëmbimi dhe injoranca?! Të gjithë ne themi: jo. Të gjithë e kujtojmë fjalën e të Dërguarit sal-IAllahu alejhi ue sel-lem:

إِذَا حَكَمَ الْحَاكِمُ فَاجْتَهَدَ ثُمَّ أَصَابَ فَلَهُ أَجْرَانِ، وَإِذَا حَكَمَ فَاجْتَهَدَ ثُمَّ أَخْطَأَ فَلَهُ أَجْرٌ

**“Kur gjykatësi<sup>18</sup> dëshiron të gjykojë, përpiket dhe ia qëllon, ka dy shpërblime dhe kur gjykon e përpiket pastaj gabon, ka për të një shpërblim.”<sup>19</sup>**

Përse harrojmë që muxhtehidi mund të shpërblehet vetëm me një shpërblim dhe nuk themi: “Gabo!”?! Sepse disa njerëzve u rëndohet kur dikush thotë: “Imam filani gaboi”. Por siç thonë: “Të gjithë shtigjet të çojnë tek mulliri”. Pyesim, përse ky ekzagjerim?! Përse frikësohemi të themi që një imam nga imamët e muslimanëve në një çështje të caktuar, në një përpjekje apo në një mendim të tijin gaboi dhe të shpërblehet me një shpërblim në vend që të marrë dy?! Përse se themi këtë së pari si pikënisje dhe së dyti si praktikim i disa degëve që prej tyre është edhe kjo që po përmendim?!

---

<sup>18</sup> Thotë imam Neueui –Allahu e mëshiroftë-: “Dijetarët kanë thënë se muslimanët janë unanimit që ky hadith është për gjykatësin, dijetarin dhe të aftin për të gjykuar. Nëse e qëllon ka dy shpërblime, një shpërblim për përpjekjen dhe një për saktësinë. Nëse gabon ka vetëm një shpërblim për përpjekjen e tij.” (Sherh ala Sahih Muslim 12/13-14) (shp)

<sup>19</sup> Buhariu 7352, Muslimi 1716.

Kur lexon librin që ky dijetar e shkroi në formë kritike për autorin në fjalë, nuk del me përfundimin se autori gaboi që u mbështet tek mendimi i një imami nga imamët e muslimanëve, sepse ky mendim pas shoshitjes dhe shqyrtimit përballë argumenteve të Sheriatit, i ka detyruar edhe vetë disa nga ndjekësit e imanit ta braktisin këtë çështje, e t'ia lënë atë imanit si një shpërblim të vetëm dhe të kapen pas haditheve të sakta. Përse në këtë libër nuk e shohim të shkruar që imami gaboi dhe njëkohësisht është i shpërblyer, dhe se autorit nuk i lejohet që të kundërshtojë Sunetin me mendimin e këtij imami?!

Përgjigjja është se gjynahet na janë mbështjellë dhe në zemrat tona ekziston shenjtërimi i imamëve dhe nderimi i tyre me tepër seç na e ka obliguar Allahu.

Ne besojmë në fjalën e të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem për ne:

ليسَ مِنَّا مَنْ لَمْ يُجِلِّ كَبِيرَنَا، وَيَرْحَمْ صَغِيرَنَا ! وَ يَعْرِفْ لِعَالِمِنَا حَقَّهُ

**“Nuk është prej nesh ai që nuk respekton të madhin tonë, nuk mëshiron të voglin tonë e nuk ia njih dijetarit tonë të drejtën e tij.”<sup>20</sup>**

Kjo është diçka që i Dërguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i ka nxitur muslimanët, pra të njohin të drejtën e dijetarit, por a është nga e drejta e tij që ta ngremë në gradën e pejgamberëve dhe të dërguarve, derisa ta bëjmë të pagabueshëm me gjuhën e veprimeve tona?! E gjuha e veprimeve flet më shumë se gjuha e folur.

---

<sup>20</sup> Sahih El Xhami' 5443.

Nëse duhet ta nderojmë dijetarin, t'i japim vendin që i takon dhe ta pasojmë kur na paraqet argumentin, nuk na takon të ngremë fjalën e tij e të ulim fjalën e të Dërguarit, as t'i japim përparësi fjalës së tij përpara fjalës së të Dërguarit! Ky është një tjetër shembull nga shembujt që akoma vazhdojnë të jenë të përhapur tek ne, pa u mohuar dhe kundërshtuar nga ana e dijetarëve me Kuran e Sunet.

E kam përmendur këtë në një libër të botuar timin, dhe ishte e domosdoshme që lexuesi të dilte me një përfundim, i cili është se: çështja është vetëm ashtu siç e ka thënë Pejgamberi sal-Allahu alejhi ue sel-lem:

ما أَسْكُرُ كَثِيرُهُ، فَقَلِيلُهُ حَرَامٌ

**“Çfarë të deh me shumicë, është haram me pakicë”,**<sup>21</sup> e ky autor tek revista “El Arabij” ka gabuar, dhe kujt i është referuar nga dijetarët ka gabuar. Tek ne nuk ka favorizim për dikë në qoftë se gabon, gabimi është gabim dhe kufri është kufër; e bëri madhi apo i vogli, mashkulli apo femra, të gjitha janë gabime dhe nuk ndryshon gabimi nëse ndryshon prejardhja.

Ja një shembull tjetër tek rregullat e martesës, e cila vazhdohet deri sot të punohet me të, tek ligjet të cilat quhen “gjendje civile”.

Sot është e ditur se ligjet fatkeqësisht na janë imponuar, dhe në to ka gjëra që unanimisht e kundërshtojnë sheriatin, porse ky gjykim vazhdon të jetë prezent si mendim i nderuar Islam. Akoma vazhdohet të gjykohet që vajza muslimane e rritur dhe e

---

<sup>21</sup> El Irua 2375.



pjekur i lejohet ta martojë veten e saj, pa lejen e përgjegjësit, me gjithë fjalën e qartë të Pejgamberit sal-Allahu alejhi ue sel-lem:

أَيُّمَا امْرَأَةٍ نَكَحْتُمْ بِغَيْرِ إِذْنِ وَلِيِّهَا فَنِكَاحُهَا بَاطِلٌ فَنِكَاحُهَا

بَاطِلٌ

**“Çdo grua që martohet pa lejen e përgjegjësit të saj; martesë e saj është e kotë, martesë e saj është e kotë, martesë e saj është e kotë.”**<sup>22</sup> Ky hadith nuk zbatohet, kurse punohet dhe gjykohet me atë fjalën tjetër.

Disa njerëz mund të thonë: nuk e paska kuptuar hadithin dikush tjetër përveç teje?!

Them: këtë hadith e ka marrë imami që më mirë e kupton gjuhën arabe dhe stilistikën të saj, ai është imam Shafiu. Ky nuk është mendim i një personi me prejardhje nga Shqipëria, por ky shqiptar gjeti një hadith dhe gjeti kuptimin (e hadithit) nga një imam, dhe ai është imam Kureshij Muttalebij.<sup>23</sup>

Pastaj, përse u la pas dore ky mendim i saktë i bashkangjitur me këtë hadith të saktë për mendimin e një imami tjetër nga imamët e muslimanëve?! Po, me gjithë mend që ixhtihadi i imamit është i respektuar, mirëpo ai ka vlerë kur nuk kundërshtohet me tekstin e pagabueshëm prej Kuranit dhe Sunetit.

---

<sup>22</sup> El Irua 1840.

<sup>23</sup> Prejardhja më e nderuar në të cilën ishte edhe i Dërguari i Allahut. (shp)

Të gjithë ne lexojmë në librat e usulit thënieën: “Kur vjen transmetimi bëhet i kotë mendimi”, dhe “kur vjen lumi i Allahut pushon së ekzistuari lumi i Ma’kilit”<sup>24</sup>, dhe “ska ixhtihad kur gjendet teksti (në Kuran e Sunet)”. Të gjitha këto rregulla janë të njohura teorikisht, atëherë përse nuk angazhohemi në zbatimin e këtyre rregullave praktikisht, dhe vazhdojmë të kapemi në disa degëzime që kundërshtojnë Sunetin?!

Nëse duam të marrim ilaçin e përcaktuar nga i Dërguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem pas përshkrimit të sëmundjes: **“Derisa të ktheheni në fenë tuaj”**, a është kthimi tek feja vetëm me fjalë, apo është me besim e me punë?!

Shumë muslimanë dëshmojnë La ilahe il-Allah, Muhamedun resulu-llah,<sup>25</sup> dhe nuk kryejnë kërkesat çfarë kërkojnë këto dëshmi, e ky është studim i gjatë. Shumë nga muslimanët sot – edhe ata që llogariten se janë nga orientuesit – nuk i japin fjalës La ilahe il-Allah të drejtën e saj në komentim. Këtë e kanë kuptuar shumë të rinj e autorë muslimanë; që prej të drejtës së kësaj dëshmie është se gjykimi i takon Allahut. Po, dua ta them këtë qartë: sot e kanë kuptuar këtë fakt të rinjtë muslimanë dhe shkruesit e tyre, e ajo është se gjykimi i takon Allahut dhe vetëm Atij, se imponimi i ligjeve tokësore, dhe marrja e tyre për bazë në zgjidhjen e problemeve të ngritura sot, bie ndesh me faktin se gjykimi i takon Allahut. Mirëpo, unë shoh se

---

<sup>24</sup> Thealebiu thotë: “Lumi i Ma’kilit është në Basra.” Gjithashtu thotë: “Kanë për qëllim me “lumi i Allahut” detin, shiun apo vërshimin, sepse ato mbizotërojnë mbi gjithë ujërat dhe lumenjtë e i mbulojnë ato.” Thimarur Kulub 33. (shp)

<sup>25</sup> Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe Muhamedi është i Dërguari i Allahut. (shp)

shumë nga këta autorë nuk i mbahen kësaj vërejtje të rrezikshme të cilën e kanë kuptuar, e ajo është se gjykimi i takon Allahut dhe gjykimi i Allahut është gjykimi i Kuranit e Sunetit.

Habitem me faktin se nëse vjen një gjykim i kundërt nga filan jobesimtar, ky është në kundërshtim me ligjin e Allahut dhe nëse vjen nga përpjekja e muxhtehidit gabimtar, atëherë nuk na genka në kundërshtim me ligjin e Allahut?!

Unë besoj se ska dallim, pasi është obligim për muslimanin që mos të marrë asnjë fjalë, cilido qoftë burimi i tij, duke qenë se ajo e kundërshton Kuranin dhe Sunetin; porse ka dallim ndërmjet atij që tha këtë kufër, pasi ai është mosbesimtar që do të qëndrojë përgjithmonë në Zjarr, dhe ndërmjet atij që e tha këtë gjë gabim prej muslimanëve, pasi ai është i shpërblyer në gabimin e tij, siç e përmendëm këtë tek hadithi i saktë.

Pra, është obligim kthimi në fe pas përpjekjes dhe ndjekjes së rrugës së kuptimit të kësaj feje, e kjo bëhet duke zbatuar fik'hun i cili sot quhet fik'hu krahasues apo i krahasuar. Ky fik'h duhet dhënë mësim dhe duhet mësuar nga të specializuarit që mbajnë diploma të shariatit, të fik'hut dhe hadithit.

Kur thërrasim për formimin e shtetit Islam, atëherë ky shtet patjetër duhet të ketë kushtetutë të qartë dhe ligje edhe me të qarta. Pra, në cilin medh'heb do të ngrihet kjo kushtetutë?! Në cilin medh'heb do të komentohet kjo kushtetutë ligjesh?!

Disa autorë muslimanë sot japin detaje të disa ligjeve mbi të cilat është obligim ngritja e dispozitave të shtetit të lakmuar musliman, mirëpo gjejmë se këto ligje nuk janë ndërtuar me

studim – sipas rrugës që orientuam, e ajo është fik’hu krahasues që sipas përkufizimit tonë kihet për qëllim: studim i Kuranit e Sunetit – porse ky person mësoi një medh’heb, dhe tejçon mendimet e medh’hebit në shumë nga degëzimet të cilat i bëri ligje dhe i vendosi në një libër, që kur shteti Islam të ngrihet – shpresojmë të jetë afër – të jetë ky ligji i saj. Ky në realitet nuk ka sjellë diçka të re, ashtu si autori i librit “Pijet dehëse” nuk erdhi me diçka të re, mirëpo e reja që ne duam është zgjimi i muslimanëve.

Por, më e pakta që mund të themi: është saktësuar fjala tjetër që e mori atë imami tjetër; sepse ajo është ndihmuar me Sunet. Kjo që po vë theksin, ka ardhur tek neni: “Kur muslimani vret besëdhuruarin (edh-dhimij)<sup>26</sup> atëherë ai vritet”. Ky është mendim i njohur në fik’hun Islam, por ka një mendim tjetër krahas tij dhe i kundërt me të, që thotë: “Kur muslimani vret besëdhuruarin atëherë nuk vritet”, për shkak të fjalës së tij sal-Allahu alejhi ue sel-lem në sahihun e Buhariut:

لا يُقْتَلُ مُسْلِمٌ بِكَافِرٍ

**“Nuk vritet një musliman (krahas) me jobesimtarin.”<sup>27</sup>**

Çfarë e bën këtë dijetar të nderuar dhe shkrimtar të kohës sonë të vendosi në rregullat Islame dhe kushtetutën Islame që

---

<sup>26</sup> Personit që i është dhënë besa të qëndrojë në vendet islame duke iu garantuar siguria e ai paguan xhizjen. (shp)

<sup>27</sup> Për vrasjen me dashje ka ndëshkim (*Taazir*) dhe shpajim gjaku, kurse për atë pa dashje ka vetëm shpajim. Nga Shpjegimi i “Bulug El Meram” i Shejh Abdulaziz ibën Baz kapitulli “El Xhinajat”. (shp)

muslimani të vritet me jobesimtarin, duke rënë ndesh me hadithin e të Dërguarit sal-IAllahu alejhi ue sel-lem?!

Mendoj se shkakut është se ai ka mësuar këtë fik'h me të cilin është rritur, andaj e bëri atë fik'h të detyrueshëm. A është kjo gjë kthimi në fe?!

Feja thotë:

لا يُقْتَلُ مُسْلِمٌ بِكَافِرٍ

**“Nuk vritet një musliman (krahas) me jobesimtarin.”**

Por, medh'hebi thotë vritet me të. Gjithashtu vetë ky shkruet thotë në të njëjtën temë: “Kur muslimani vret besëdhenuarin gabimisht, sa është shpagimi i gjakut të tij (*ed-dijjetu*)? Shpagimi i gjakut të tij është sa shpagimi gjakut të muslimanit!” Kështu thotë ligji që pason medh'hebin në të cilin u mbështet në të. I Dërguari sal-IAllahu alejhi ue sel-lem thotë:

دِيَّةُ عَقْلِ الْكَافِرِ نِصْفُ عَقْلِ الْمُؤْمِنِ

**“Shpagimi i gjakut të jobesimtarit është sa gjysma e shpagimit të gjakut të besimtarit.”<sup>28</sup>**

Pra, a ta bëjmë këtë për ligj, apo fjalën që e kundërshton?! Ka edhe shumë shembuj të tjerë.

Kthimi në fe është kthimi në Kuran dhe Sunet, sepse kjo është feja me unanimin e imamëve, e ajo është ruajtja (garancia)

---

<sup>28</sup> Sahih El Xhami' 3391.

nga rrëshqitja dhe rënia në humbje. Për këtë shkak, thotë i Dërguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:

رَكْتُ فِيكُمْ شَيْئَيْنِ ، لَنْ تَضِلُّوا بَعْدَهُمَا : كِتَابَ اللَّهِ ، وَ سُنَّتِي ، وَ لَنْ يَتَفَرَّقَا حَتَّى يَرِدَا عَلَيَّ  
الْحَوْضَ

**“Kam lënë tek ju dy gjëra, nuk do humbisni pas tyre: Librin e Allahut dhe Sunetin tim. Këto dy nuk do të ndahen derisa të vijmë tek unë në haud<sup>29</sup>.”<sup>30</sup>** Ne sollëm disa shembuj, të cilat ia bëjnë obligim dijetarëve sot që të kthehen në kuptimin e fesë sipas dy bazave të saja të lartpërmendura: Kurani dhe Suneti, që të mos bien muslimanët në lejimin e asaj që e ndaloi Allahu, duke hamendësuar se është prej gjërave që Allahu i ka lejuar.

Dhe tani fjala ime e fundit rreth kthimit në fe:

Në qoftë se duam krenarinë nga Allahu i Lartësuar, të na e ngrejë poshtërimin nga ne dhe të na ndihmojë mbi armikun, nuk mjafton për këtë gjë ajo çfarë treguam rreth obligimit të saktësimit të kuptimeve, dhe largimit të mendimeve të cilat keqinterpretuan argumentet e sheriatit tek dijetarët dhe tek fukahatë që janë të kësaj fushe.

Por, këtu është edhe një gjë tjetër shumë e rëndësishme – ajo është thelbi i fjalës – lidhur me korigjimin e kuptimeve, e ajo është puna; sepse dija është rruga që të shpie për tek puna. Kur njeriu mëson dhe dija e tij është e pastër, mirëpo pastaj nuk

---

<sup>29</sup> Haudi është lumi Keuther që Allahu iu dha Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në Ahiret. (shp)

<sup>30</sup> Sahih El Xhami’ 2937.

punon me të, është shumë e thjeshtë që kjo dije nuk do japi fryt, andaj patjetër duhet bashkuar puna me këtë dije.

Për dijetarët është obligim që të marrin përsipër edukimin e brezit të ri musliman, nën dritën e asaj që është saktësuar në Kuran dhe Sunet. Nuk lejohet t'i lemë njerëzit në atë që trashëguan prej kuptimeve dhe gabimeve, ku një pjesë e tyre është padiskutim e kotë me unanimitet të imamëve, e një pjesë tjetër ka mospajtim, ka këndvështrim, ixhtihad dhe mendim, ku një pjesë e këtij ixhtihadi dhe mendimi kundërshton Sunetin.

E pas dëlirjes (*et-Tesfije*) të këtyre çështjeve dhe qartësimit se me çfarë është obligim të niset dhe ecet me to, patjetër duhet bërë edukimi (*et-Terbije*) i brezit të ri sipas kësaj dije të saktë.

Ky edukim do të na çeli një shoqëri të pastër Islame, dhe si rrjedhojë do të na ngrrejë shtetin Islam.

Pa këto dy parathënie: “Dituria e saktë” dhe “edukimi i saktë me këtë dije të saktë”, është e pamundur – në besimim tim – që të ngrihet Islami, gjykimi Islam apo shteti Islam.

Po jap një shembull për domosdoshmërinë e edukimit të saktë mbi dijen e saktë: tek ne në Sham gjendet një grupim musliman që dëshiron të punojë për Islamin, të drejtohet me të, të edukohet dhe edukoje brezin e ri në të, porse e dimë plotësisht që shumë nga orientuesit e tyre kanë vetë nevojë ta sduotiojnë gjerësisht Islamin; sipas kësaj rruge të shëndoshë e të saktë të cilën e treguam dhe siç e sqaruam më parë.

Shohim që shumë nga djemtë muslimanë fillestarë, thërrasin njeri tjetrin për t'u grumbulluar natën e xhumasë për ta gjallëruar atë (me namaz). Kjo është thirrje në bindje të Allahut dhe adhurimin e Tij. Kjo gjë është shumë e bukur, mirëpo për shkak se ata nuk e kanë studiuar Sunetin, nuk e kanë mësuar dhe nuk e kanë gjetur brezin që t'i edukonte që në moshë të njomë, bien në kundërshtimin e tij. Po tregojmë fjalën e të Dërguarit sal-Allah u alejhi ue sel-lem:

لَا تَخْتَصُّوا لَيْلَةَ الْجُمُعَةِ بِقِيَامٍ مِنْ بَيْنِ اللَّيَالِي، وَلَا تَخْتَصُّوا يَوْمَ الْجُمُعَةِ بِصِيَامٍ مِنْ بَيْنِ الْأَيَّامِ

**“Mos e veçoni natën e xhuma me namaz nate ndërmjet netëve të tjera! Mos e veçoni ditën e xhuma me agjërim ndërmjet ditëve të tjera.”**<sup>31</sup> Si t'a gjallërojmë natën e xhuma dhe i Dërguari sal-Allah u alejhi ue sel-lem na ka ndaluar nga kjo?!

Përgjigjja: kjo, sepse tek ne nuk ka dituri.

Është obligim që orientimi të vinte nga dijetarët, që kjo natë nuk lejohet gjallërimi i saj, për shkak të fjalës se tij që e përmendëm më sipër.

Do të gjesh të tjerë prej këtyre djemve të mirë, që e bëjnë të lejuar dëgjimin e këngëve dhe veglave muzikore! Kjo, sepse i gjejnë radiot që t'i mbushin veshët, dhe nuk ka këshillë të përgjithshme për këtë brez të ri musliman, që i Dërguari sal-Allah u alejhi ue sel-lem i ka ndaluar veglat muzikore, ka paralajmëruar nga dëgjimi i tyre, ka kërcënuar ata që ngrysen në

---

<sup>31</sup> Muslimi 1133.



dëfrim, lojë dhe dëgjojnë muzikën, se do të shndërrohen në majmuna dhe derra.<sup>32</sup>

Ky brez i ri nuk është edukuar në njohjen e asaj që lejohet e që nuk lejohet, ngase ai gjen fjalë të shumta; gjen për shembull imam Ibën Hazmin që ka një libër në lejimin veglave muzikore, dhe shumë shpejt ky libër botohet e përhapet ndërmjet njerëzve, që përputhet me epshin e dikujt prej tyre.

Ndoshta ndonjë nga orientuesit dhe dikush që pretendon përmirësimin ka thënë: përderisa ky është imam dhe ka të tillë mendim, atëherë ne e ndjekim apo e pasojmë qorrazi në dëgjimin që i bëjmë veglave muzikore, sidomos kur kjo bela ka pllakosur gjithandej.

Po ku është Suneti atëherë?! Suneti është bërë diçka e harruar!

Nëse i Dërguari sal-Allahü alejhi ue sel-lem përcaktoi ilaçin për ngritjen e poshtërit kaplues mbi ne, që ishte kthimi në fe, atëherë është obligim për ne që ta kuptojmë fenë përmes dijetarëve, me një kuptim të saktë, në përputhshmëri me Kuranin dhe Sunetin, e të edukojmë brezin e dobishëm dhe të mirë në të. Kjo është rruga e shërimit të problemit që prej tij ankon çdo musliman.

Më ka mahnitur një fjalë – që në realitet është si ajka a asaj që thashë apo sqarova me parë – e njërit prej përmirësuesve në kohën e sotme. Për mendimin tim, është sikur të jetë prej

---

<sup>32</sup> Es Sahihah 91.

shpalljes nga qielli; thotë: “Ngriheni shtetin Islam në zemrat tuaja, do t’u ngrihet për ju në tokën tuaj.”

Patjetër duhet të rregullojmë vetet tona mbi bazën e Islamit dhe fesë tonë, e kjo – siç e përmendëm – nuk bëhet me injorancë, por me dije; që të ngrihet shteti Islam mbi tokën tonë.

Në përfundim: këshilloj çdokënd që ka mundësi të marrë pjesë në realizimin e kësaj çështjeje të madhe, që të ndihmojë ai dhe të tjerët – nga të specializuarit – që të sqarojnë Islamin që ka ardhur në Kuran dhe Sunet, të edukojnë brezin e ri në të. Ky është përkujtim dhe përkujtimi i bën dobi besimtarëve.

Ue es-selamu alejkum ue rahmetullahi ue berekatuhu.

**Përktheu: Jusuf Kapidani**

